



Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Data: 26.07.2022

Numri i vrojtimit të lejes:

07 Nr.553/350-34197

- Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit e Komunës së Suharekës, në bazë të kërkesës së z. Besim Kabashi nga Suhareka, Komuna Suharekë, 07 Nr.350-34197 të datës 08.06.2022 në të cilën kërkon dhënien e lejes për riparim - renovim të objektit banimor, e në bazë të nenit 5, 14 dhe 21 të Ligjit të ndërtimit Nr. 04/L-110, nenit 3, 31, 36 dhe 42 të Rregullores mbi rregullat dhe procedurat e ndërtimit të objekteve 01Nr.-16-423 dt. 26.01.2011, nenit 35 dhe 114 të Vendimit për mirëmbajtjen e pastërtisë dhe shërbimeve komunale në territorin e komunës së Suharekës 01 Nr. 109 /2001 të datës 16.03.2001 si dhe nenit 44, 47, 48 e 125 të LPA-së bie këtë:

PËLQIM

Ky dokument lëshohet për:			
Emri:	Besim Ruzhdi Kabashi	Nr. Personal	
Adresa:	Rr. "Nëna Terezë" Nr. 4 Suharekë.	Telefoni:	
Email :		Kërkesa Bazë:	Pëlqim - leje për renovim të objektit banimor P+1 në Suharekë.

Përshkrimi:

I LEJOHET – investuesit – z. **Besim Kabashi** nga Suhareka, Komuna Suharekë, - kryerja e punimeve ndërtimore për riparimin - renovimin e objektit banimor Nr.4 me katshmëri P+1 në rrugën "Nëna Terezë" në parcelën kadastrale Nr.P-72116046-00676-1, vendi i quajtur "Fshat", zona kadastrale Suharekë, Komuna Suharekë.

Të gjitha punimet për renovim të objektit banimor P+1 - lejohen të bëhen sipas përshkrimit teknik dhe projektit ideor të dorëzuar së bashku me kërkesën 07 Nr. 350-34197 të datës 08.06.2022 pranë kësaj Drejtorie.

Sipërfaqja e përgjithshme e objektit banimor P+1 është: **88.47m²**.

Objekti duhet të nënshtrohet intervenimit inxhinierik të realizimit të riparimit – renovimit dhe **adaptimit funksional** për nevojat e investitorit **për përmirësimin e nivelit të jetesës – banimit**.

Objekti duhet të ngelet në gabaritin ekzistues pas riparimit – renovimit e gjithnjë në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar.

Për çdo rrezikim - të stabilitetit të objekteve përgjegjësinë e bart investuesi dhe inxhinjeri i ndërtimit.

Lartësia, fasada dhe të gjithë parametrat urboarkitektonik të mbeten të njëjtë si në gjendjen ekzistuese (pos zgjerimit të hapësirave dhe renovimit të brendshëm e gjithnjë në përputhje me përshkrimin teknik dhe projektin ideor të dorëzuar).

Rregullimi i hapësirave – hyrja në objekt, pamjet nga rruga kryesore gjegjësisht fasada duhet të punohen sipas përshkrimit teknik dhe projektit ideor në të cilin është paraparë fasadë termoizoluese t=10cm. - me komplet punimet deri në finalizim të fasadës.

Kulmi mbetet i njëjtë, vetëm hiqen sallonitët dhe vendosen tjegullat.

Gjithashtu lejohet pastrimi i oborrit dhe terenit në tërësi nga mbeturinat. Pos materialit të cilin mundet ta shfrytëzojë pas renovimit, tërë materialin tjetër - mbeturinat e ndryshme duhet të i transportojnë në deponi legale të qytetit, e nën mbikëqyrjen e inspektionit kompetent të Komunës dhe se nuk kanë të drejtë që mbeturinat të i hedh jashtë këtij vendi.

Gjatë kryerjes së punimeve punë kryesi vendin ndërtimor duhet patjetër ta siguroj në mënyrë të vulltshme, në pajtim me dispozitat e mbrojtjes në punë - sipas nenit 35 dhe 114 të Vendimit për mirëmbajtjen e pastërtisë dhe shërbimeve komunale në territorin e komunës së Suharekës - 01 Nr. 109/2001 të datës 16.03.2001 .

Punimet duhet të kryhen në atë mënyrë që të mos e pengon lëvizjen e lirë të qytetarëve.

Punimet duhet të kryhen në atë mënyrë që të mos e pengon zhvillimin e komunikacionit.

Gjatë punimeve për prishjet eventuale në infrastrukturë përgjigjet vet punë kryesi – investitori.

Gjatë kryerjes së punimeve investuesi gjegjësisht kryesi i punimeve është i obliguar që të i përmbahet rregullave tekniko - ndërtimore të ndërtimit dhe pas përfundimit të punimeve **vendin ndërtimor ta kthejë në gjendjen e mëparshme.**

Investuesi është i obliguar që tetë (8) ditë para fillimit të punimeve gjegjësisht renovimit të objektit ta njoftoi këtë Drejtori dhe Drejtorinë e Inspekcionit për ditën e fillimit të punimeve .

Për mos kryerje të punëve sipas këtij Pëlqimi, inspekcioni përkatës do të veproj sipas rregullave të parapara me ligj.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës 07 Nr. 350-34197 të datës 08.06.2022 nga z. Besim Kabashi nga Suhareka, Komuna Suharekë, në të cilën kërkon **dhënien e lejes për riparim - renovim të objektit banimor Nr.4, me katshmëri P+1 për krijim të kushteve sa më të mira për jetesë**, ky Organ përmes shërbimit të vetë teknik e pas shqyrtimit të parashtrësës dhe shtojcave ka konstatuar se parashtruesit të kërkesës mundë të i jepet leja ndërtimore gjegjësisht **PËLQIMI** për kryerjen e punimeve të lartpërmendura.

Kërkesës i është bashkangjitur edhe dëshmia mbi pagesën e Pëlqimit për kryerjen e punimeve ndërtimore konform Rregullores mbi tarifrat dhe ngarkesat 01 Nr. 16-12102 të datës 01.12.2015 - sipas nenit 8. pika 8.8.5. - në vlerë prej **15.00** euro.

Udhëzime Juridike: Kundër këtij Pëlqimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese - MMPHI-së Prishtinë, përmes kësaj drejtorie, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të së njëjtit.

Pëlqimi i dërgohet:

-Parashtruesit të kërkesës, Inspektorit Komunal dhe dosjes së DUP-it.

Zyrtari përgjegjës:
Agron Bajraktari



Drejtori i Drejtorisë:
Visar Kuçi

